



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 28 .07. 2025

Nr. 1215/2 prot.

VENDIM

Nr. 19 datë 25 .07 .2025

“ PËR SHPALLJEN E TË SHTUNËS SË DYTË TË GUSHTIT SI EVENTIN LOKAL TË PËRVITSHËM “DITA E BAMIRËSISË”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 25 “*Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese*”, si dhe në përputhje me objektivat për promovimin e vlerave qytetare, solidaritetit dhe nxitjes së veprimtarive sociale, artistike dhe kulturore me ndikim në komunitet, Këshilli i Bashkisë Pukë, me propozim të kryetarit të Bashkisë, pas shqyrtimit në mbledhjen e dates 25.07.2025;

VENDOSI:

1. Shpalljen e të Shtunës së dytë të Gushtit të çdo viti si “Dita e Bamirësisë”, një event lokal që do të organizohet dhe promovohet në territorin e Bashkisë Pukë.
2. Qëllimi i këtij eventi është nxitja e vlerave qytetare, bamirësisë, përfshirjes sociale, manifestimeve artistiko-kulturore, përmes një atmosfere festive, pozitive dhe gjithëpërfshirëse.
3. Ky event, i cili synon promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal, do të konsiderohet si një festë lokale e përvitshme dhe do të përfshijë aktivitete të ndryshme për nxitjen dhe promovimin e vlerave të bamirësisë në komunitet, përmes organizimit të veprimtarive sociale, artistike, kulturore, sportive, çlodhëse e argëtuese.
4. Festimet e “Ditës së Bamirësisë” do të organizohen çdo vit të shtunën e dytë të muajit Gusht, për të mundësuar pjesëmarrje sa më të gjerë të qytetarëve, turistëve dhe emigrantëve.
5. Per zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen strukturat përkatëse të Bashkisë Pukë për hartimin dhe zbatimin e planit organizativ të festës, në bashkëpunim me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë lokalë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , neni 55, pika 6.
7. Vendimi u shpall me datë 28.07. 2025.
Vota të vlefshme gjithsej 8
Vota pro 8 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA

